

Termet e Referencës: Ekspert për Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Peizazhin e Mbrojtur Ujor/Tokësor të Liqenit të Pogradecit (PA_025), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të kryer një studim në lidhje me "Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush".

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të prodhojë një raport mbi Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush.

3. Qëllimi

Eksperti do të jetë përgjegjës për prodhimin e një raporti mbi Protokollin e Monitorimit për Pyjet me Dushk dhe Bush, që do të ndihmojë AdZM-në e Korçës në zbatimin e protokollit të monitorimit të habitatit.

4. Kohëzgjatja

Konsulenca pritet të fillojë më 25 korrik dhe të përfundojë më 15 shtator. Fokusi i detyrës do të jetë Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor i Liqenit të Pogradecit.

5. Raportimi

Eksperti do të dorëzojë një raport tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

6. Kualifikimet

Kandidati duhet të ketë:

- a. 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit
- b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Peizazhit të Mbrojtur Ujor/Tokësor të Liqenit të Pogradecit
- c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

7. Buxheti

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 2.5 "Protokoll Monitorimi për Pyjet me Dushk dhe Bush"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 1300 Euro

8. Procesi i Aplikimit dhe Afati

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 22 korrik në adresën info@akzm.gov.al